**KËRKESË**
**Nr. 77/13, datë 29.7.2024**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikonstruksion i rrugëve 'Faik Pajuni' dhe 'Alush Lleshanaku' në ZK 8521, Bashkia Elbasan'", me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 1,698,683.8 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre pikë tetë) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Elbasan.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Elbasan, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,698,683.8 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre pikë tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR
I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMIT
**Kastriot Gurra**

# LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “RIKONSTRUKSION RRUGËVE ‘FAIK PAJUNI’ DHE ‘ALUSH LLESHANAKU’ NË ZK 8521”, ELBASAN

| NR. | PRONARI | | | TË DHËNA HIPOTEKORE | | | | | | | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM: "ARË" | | | "TRUALL" | | | "NDËRTESË" | | | Vlerat e kultura bujqësore dhe drufrutorëve sipas procesverbalit të Drejtorisë së Bujqësisë | | VLERA TOTALE (lekë) | SHËNIME (D+E) (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | EMRI | ATËSIA | MBIEMRI | Fshati ose qyteti | Zona kadastrale | Nr. pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja totale | "Arë" ($m^2$) | "Truall" ($m^2$) | "Ndërtesë" ($m^2$) | Volumi | Faqe | Sipërfaqja (m2) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | Sipërfaqja ($m^2$) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | Sipërfaqja ($m^2$) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | Vlera e kulturës bujqësore (lekë) | Vlera e drufrutorëve (lekë) | | |
| | A | B | C | C | Ç | D | E | F | G | H | I | J | K | L | M | N | O | P | Q | R | S | T | U | V | Y | Z |
| 1 | BEQIR<br>NEKTAR<br>SOPOT<br>DHURATA<br>DASHAMIRA | BUKUROSH<br>BUKUROSH<br>BUKUROSH<br>BUKUROSH<br>BUKUROSH | SEJDINI<br>SEJDINI<br>SEJDINI<br>SEJDINI<br>SEJDINI | ELBASAN | 8521 | 3/486 | TRUALL | 150 | 0 | 150 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 84.3 | 13666 | 1152043.8 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1152043.8 | |
| 2 | BESNIK | SHAZIVAR | MUZHAQI | ELBASAN | 8521 | 3/225 | TRUALL | 40 | 0 | 40 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 40 | 13666 | 546640 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 546640 | |
| 3 | SHTET | | | ELBASAN | 8521 | 3/503 | TRUALL | 8311.7 | 0 | 8311.7 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2505 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| | SHUMA | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 1698683.8 | |

Çmimet për pasuritë e llojit arë+truall janë marrë nga harta e vlerës, miratuar me VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016